REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 59-65/17
Datë/Datum 24.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"Korporata Energjetike e Kosovë"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP** **Nr. 59 - 65/17**
Nga:	Halil Hoti – Ekspert Teknik Visar Bibaj - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raport për lëndën **"Pastrimi i sipërfaqeve të këmbyesve termik** me nr. të Prokurimit: **KEKC 16/395/521.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**1. AR TECH sh.p.k – Prishtinë** **2. NPSH "Electronik "Business-Pro"-Prishtinë**		
Datë	**24.03.2017**		

1. Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Pastrimi i sipërfaqeve të këmbyesve termik"** me nr. të Prokurimit: **KEKC 16/395/521,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **"Korporata Energjetike e Kosovës",** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **"AR-TECH" sh.p.k-Prishtinë** me nr. prot. **59/17,** të datës **28.02.2017** dhe Operatorit ekonomik: **NPSH Electronik "Business-Pro"-Prishtinë** me nr. prot. **, 65/17** të datës **06.03.2017**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES - TEKNIK

		15.03.2017		**20.03.2017**		**24.03.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **28.02.2017**, OSHP, ka pranuar ankesën nga OE **"AR-TECH" sh.p.k** - Prishtinë, me nr. **59/17**, poashtu me daten, **06.03.2017**, OSHP, ka pranuar ankesen me nr **65/17**, nga OE **NPSH Electronik "Business-Pro"** - Prishtinë, kundër AK - **Korporata Energjetike e Kosovës,** lidhur me aktivitetin të prokurimit: **"Pastrimi i sipërfaqeve të këmbyesve termik"**, me nr. të Prokurimit: **16/395/521**.

Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues - teknik e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Korporata Energjetike e Kosovës.**

N.111,LPP - Operatoret Ekonomik Ankues "AR-TECH "sh.p.k , me seli në Prishtine

Pikat e Ankesës nga OE **"AR-TECH" sh.p.k** nga **Prishtina**, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

- Neni 1 Qëllimi i Ligjit
- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiti
- Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi
- Neni 28 Specifikimet Teknike
- Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Operatori Ekonomik Ankues "AR-TECH"sh.p.k, me seli në Prishtine

Konsiderojme se AK ka shkelur nenin 59 paragrafi 2 pasi qe nuk e ka respektuar 28 paragrafi 9teLigjit Nr. 04/L-042 për prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

4. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderuesi që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilin do nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve .Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Neni 28 Specifikimet teknike.

9 Kur autoriteti kontraktues e ka parashtruar specifikimin teknik për kërkesat ekzekutuese ose funksionale, ai nuk mund të përdorë kërkesat e tilla siarsyetim për refuzimin e tenderi...

Arsyetim:

AK KEK-sh.a. ne specifikim teknik dhe ne Dosje te tenderit ka kerkuar qe O.E. te kete

punetore te certifikuar per pune ne lartesi pa e specifikuar numrin e nevojshem.

- Ne Leter standard per tenderuesin e eliminuar te dt. 16.02.2017 ne jemi shpall te pa pergjegjshem me arsyetim se citoj: "Numri i punetoreve qe posedojne certifikaten per pune ne lartesi eshte shume i vogel (5 puntore). Krahasuar me vellimin e puneve dhe periudhen prej 18 dite per nje bllok (qe mvaret prej kohezgjatjes se remonteve) eshte e pamundur qe me kete numer te puntoreve te kryhet pune kualitative.",edhe ne pergjegjen e Kerkeses per rishqyrtim kemi pergjegjet e njejte.

- Ne oferte kemi prezentuar listen e puntoreve qe eshte planifikuar te angazhohen ne kete projekt ku shihet se nr. ipuntoreve do te jete mbi 20, punetor e te cilet jane te specializuar dhe te afte per pune ne lartesi, jane 5 punetore. Ne metodologjine per realizimin e projektit I kemi informuar per organizimin qe do ta bejme me qellim qe nese shpallemi fitues te realizojme kontraten. Stafi qe eshte cekur do te punoje se bashku dhe numri i punetoreve do te jete i mjaftueshem qe punet te kryhen si eshte cekur ne oferte, ne te kunderten ashtu si e parasheh ligji do te pranojme te gjitha sanksionet penale dhe civile.

-Pasiqe te gjitha kriteret e kerkuara ne njoftim per kontrate dhe ne dosje te tenderit ne i plotesojme kerkojme nga OSHP ta shpall oferten tone te pergjegjshm edhe te kerkoje nga AK KEK-sh.a. ta kthej lenden ne rivlersim

<u>Demi Material</u>

Dëmet materiale që mund te nashkaktohen në këtë rast janë të konsiderueshme, si ne aspektin material ashtu edhe ne prestigjin tone.

Pikat e Ankesës nga OE **NPSH Electronik "Business-Pro"-** nga **Prishtina**, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

- Neni 1- Qëllimi
- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 59 Ekzaminimi. Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Rregullat dhe Udhezimi Operativ i Prokurimit Publik 31. Validiteti i Tenderit (31.4 kerkesa me me shkrim para skdimit te afatit te validitetit te tenderit dhe 31.5 , kerkesa duhet te dergohet tek te gjithe OE. 41. Ekzaminimi. Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (41.2)

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

I. Me date 16.02.2017, menjeher pas pranimit te Letres Standarde per eleminim ne i jemi drejtuar autoritetit kontraktues, perkatesisht zyrtarit pergjegjes te prokurimit per kete aktivitet, me nje verjetje per dergimin e letres standarde per eleminim, qe siq eshte bere praktike nga ana e zyrtareve te prokurimit,qe letren standarde per eleminim ta dergojn diten e fundit te javes apo para festave vetem me qellim te shkurtimit te afatit per analizimin dhe pergaditjen e kerkeses per rishqyrtim. Ne rastin konkret, zyrtari i prokurimi e dergon letren standarde per eleminim me date 16.02.2017, nje dite para festes zyrtare qe eshte 17.02.2017 (dite e premte) dhe para vikendit, ku ne rastin konkret qellimi eshte qe koha per parshtrimin e kerkeses tone ta jete sa me shkurter. Me kete rast ne po ashtu keni kerkuar qe ne perputhje me nenin 10 te LPP dhe ate pragrafit 10.3 dhe 10.5 te kemi qasje ne dokumntacion. Po ne te njejten dite, zyrtari i prokurimit na kthen pergjegje se ne fazen ne te cilen gjindet aktiviteti i prokurimit ne nuk mund te kemi qasje ne dokumentacion dhe ne perputhje me nenin 108/A ne mund te bejme kerkesen per rishqyrtim. Bashkangjitur eshte:

6. Emaili i dates 16.02.2017 i derguar tek AK me kerkese per qasje ne dokumentacion

7. Emaili i dates 16.02.2017 i derguar nga AK me pergjejigje per mos dhenin e te drejtes per qasje ne dokumntacion.

8. Komunikimet me te njejtin zyrtare te prokurimit per nje Aktivitet tjeter te prokurimit kur nuk na eshte dhene e drejta per qsje ne dokumntacion.

Nga kjo shihet qarte se qellimet e Zyrtarit te prokurimit jane diskriminuese,tendencioze dhe mire te paramendura. Kjo do te deshmhet edhe me: Me rastin e publikimit te njoftimit per anulim te aktivitetit te prokurimit i cili publikohet me date 28.02.2017 ne nenin IV te ketij njoftimi: anulimi i procedures, pika iv.i thuhet. data e vendimit mbi anulimin e procedures 16.02.2017. Siq shihet nga kjo informate ne njoftim, pikerisht ne diten kur ne kemi bere kerkese per qasje ne dokumntacion, per kete aktivitet te prokurimit vleresimi nga ana e komisionit vleresue ka perfunduar, dhe nuk ka pasur ndonje arsye te mos lejimit te qasjes ne dokumntacion. KY moslejim ka qellim diskriminue dhe me te vetmen arsye qe ne te mos kemi mundesi qe te shohim se manipulimet e zyrtarit te prokurimit me OE te tjere. Me daten 27.02.2017, nga ana e keti zyrtari ne pranojm vendimin ne kerkesen tone per rishqyrtim duke na

refuzuar kerkesen tone, mirepo nuk e sheh te arsyeshme qe te na njoftoj se vendimi per kete aktiviet te prokurimit eshte marre dhe ne perputhje me kerkesen tone ne mund te kemi qasje ne dokumntacion sepse eshte date 27.02.2017, nje dite para publikimit te njoftimit per anulim. Sa me qfare perpikerie e ka organizuar ky zyrtare menyren se si ne te mos kemi mundesi ne qasje ne dokumntacion shihet ne pershkrimin e situates. Edhe pse Ligji e obligon zyrtarin e prokurimit qe me rastin e publikimit te cfardo njoftimi, ai duhet qe edhe OE qe kane marre pjese ne kete aktivitet ti lajmeroj se eshte bere publikimi i njoftimit , ne kete rast, zyrtari i prokurimi as qe lodhet perkete pune, sepse qellimi i tij eshte fshehja e informatave dhe jo transparenca ndaj OE. Me date 01.03.2017, duke pare se aktiviteti i prokurimit ka perfunduar, ne bejem edhe nje here kerkese tek zyrtari i prokurimit per qasje ne dokumentacion.Me date 02.03.2017, ne marrim pergjigjen nga zyrtari e ne mund te kemi qasje ne dokumentacion me date 02.03.2017 ne ora 13:00. Mirepo ne ora 12:ll ne marrin edhe nje email nga ky zyrtare se ne nuk mund te kemi qasje ne dokumntation spse OSHP ne baze te ne vendimi ka pezullaur aktivitetin e prokurimit.

Bashkangjitur eshte:

9. Emaili i derguar me kerkese per qasje ne dokumntacion dhe pergjigja e zyrtarit.

Siq shihet nga pershkrimi i situates, aq mire eshte i organizuar zyrtari i prokurimit sa qe ne koordinim me OE i i cili eshte ankuar, kane planifikuar aq mire sa qe me date 28.02.2017 ne te njejten dite kur edhe publikohet njoftimi per anulim , OE parashtron ankese me te vetmin qellim qe aktiviteti te pezullohet dhe pas shqyrtimit te ankeses nga ana OSHP, aktiviteti te kthehet ne rivleresim dhe kontrata pas rivleresimit ti ipet ketij OE, sepse sigurisht qe arsyet eleminimit te cekuar ne letren standarde per eleminimin e ketij OE, me qellim te caktuar nuk jane aq bindese per OSHP Sa OSHP te vendose ne favor te autoritetit. Kjo eshte edhe arsyeja se pse neve na eshte pamundesuar qasja ne dokumntacion vetem qe ne te mos kemi mundesi qe te shohim dokumntacionin e OE te tjere dhe te vertetohet gjendja reale. Po ashtu eshte shume me rendesi te ceket fakti se diten kur ne e kemi pranuar Letren Standarde per Eleminim, vleresimi i ketij aktiviteti nga ana e komisionit veq ka qene i perfunduar dhe pas reagimit tone ne shkresen te cilen e kemi derguar me 16.02.2017 eshte vendosur qe ky aktivitet te anulohet, dhe te gjite OE i eshte derguar letra standarde per eleminim.

Per shkak te ketyre rrethanave te pershkruara me larte , egziston dyshim i bazuar ne sjelljen jo profesionale dhe diskriminuese te zyrtarit te prokurimit dhe ne te njejten kohe bene shkelje flagrante te nenit 10 te LPP-transparencen dhe ne njejten kohe bene shkeljen e nenint 1 te LPP e qe eshte qellimi, sespe me sjelljet e veta ne cdo menyre mundohet qe te shperblej me kontrate nje OE tjeter i cili cmimin e ka me te larte se ne per saktesisht 11.100.006 e krejt kete e bene me qellim te perfitimeve personale e qe eshte ne kundershtim me ligjin dhe me etiken profesionale.

II. Ne letren standarde per eleminim nje nga arsyet e eliminimit tone nga procedurat e metejme te prokurimit ,eshte se citojm:

Nuk e plotësoni kriterin e kërkuar ne njoftim per kontrate, neni III.2.4) "Kapaciteti teknik dhe profesional" apo nenin 9. 1 te FTD-se te Dosjes se tenderit ku eshte kërkuar "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" ku eshte kerkuar. Një listë që specifikon performancën: punët e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin. Operatori ekonomik duhet të bashkangjes minimum 2 (dy) referenca për ekzekutimit të mirë te punëve të natyrës së ngjajshme në tri vitet e

fundit (2013,2014 dhe 2015), në vlera jo me pak se 70,000.00 e. Ju ne oferte keni prezentuar vetem nje oferte e cila i ka plotsu kriteret e kerkuara dhe ka qene e natyrës së ngjajshme. Siq shihet ne kete leter standarde ceket se ne nuk kemi ofruar referncat ne perputhje me kerkesat ne dosjen e tenderit. Ne realitet, ne ne refencat tona kemi prezentura nje refernce e cila eshte e natyres se njejte me punen e cila do te kryhet ne kete projekt e qe eshte "Pastrimi i siperfaqeve te kembyesve termik ne bllokun A3, A4 dhe A5 ne TCA" pune te cilat jane kryer ne periudhen 2014 dhe 2015. Me nje vlere prej rreth 71,000€. Dhe po ashtu kemi prezentuar edhe nje refrence tjeter qe eshte e natyre se ngjajshme me natyren e puneve te cilat do te kryhen ne kete projekt sepse punet jane kryer ne nje objekt industrial, kane te bejne me pastrimin dhe sanimin e objektit te kulles ftohese ne bllokun A4, pune te cilat jane kryer ne vitin 2014. Mirepo edhe pas sqarimit tone ne kereksen per rishqyrtim, komisioni i vleresimit punet rreth Sanimit te kulles ftohese nuk i llogarit si pune te natyres se ngjajshme. Siq duket komisioni ka kerkuar qe OE ne refernca te paraqes referncat te natyres se njejte me natyren e puneve te cilat do te kryhen ne kete projekt e qe eshte kerkese diskriminuaese sepse me ligjin e aplikueshem nuk eshte e lejuar qe te kerkohen refernca te natyres se njejte sepse favorizon nje OE dhe disfarorizon dhe diskriminon OE te tjere. Ne menyre qe te jene te qarte, Obligim i AK eshte qe kur kerkohet reference e natyres se ngjajshme ateher ne kerkesen e vet eshte dasht qe te pershkruaj se qfare nenkupon me refernce te natyres se ngjajshme. Punet e kryera ne Sanimin e kulles ftohese jane shume me komplekse dhe shume me te rrezikshme se sa punet te cilat do te kryhen ne pastrimin i sistemit gypor te kembyesve termik. Kete pastrim siq e cekem me larte e kemi kryer ne vitin 2014 dhe 2015 dhe saktesish e dijm se si kryhen keto pastrime dhe i takojn lemit te ndertimtaris, njejt sikurse edhe punet qe duhet te kryehn ne pastrimin e kembyesve termik. Eshe e palogjikeshme, jo profesionale, tendencioze dhe shume diskriminuese, fakti se komisioni nuk e pranon kete refernce si refernce te natyres se ngjashme sepse me kete mospranim, qellimi eshte qe me kete kontrate te shpreblehet OE i cili ka cmimin me te larte. Dhe me kete bene shkeljen e LPP, nenitl-qellimin e ligjit dhe nein 60-kriteri i dhenies se kontrates e qe eshte "Cmimi me i ulet".

III. Ne letren e vet standarde. AK ceke se:

Citojm: Është kërkuar certifikata PED 97/23 EC për kryerjen e punëve me enë nën presion, ndërsa keni ofruar certifikatën e sallduesve PED 97/23 EC për pajisje nen presion, ne kete projekt nuk ka salldim por pastrim te siperfaqeve te këmbyesve termik.

Ne kete rast, AKjo vetem qe bene diskriminim me kerkesat e veta, por ne te njejtjen kohe edhe e kundershton vetveten.

Meqense kerkesa per Certifikaten PED97/23/EC, per pastrimin e sistemit gypor ne kembyesit termik, eshte palogjikshme dhe diskriminuese, dhe nuk eshte apak e nevojshme per kryerjen e ketij pastrimi te gypave, sepse pastrimi behet ne menyre mekanike dhe pastaj me zallitje, keshtu qe nuk eshte e nevojshme qe puntoret te jene te specializuar per kete pastrim e sidomos nuk duhet te jene te specializuar me certifikaten PED 97/23/ec. Per kete arsye gjate procesit sa ky projekt ende ka qene ne periudhen e tenderimit, nje nga OE te i cili ka qene interesur qe te marre pjen ne kete tender ka bere nje pyetje ne lidhje me kte certifikat.

Pyetja eshte:

Prishtinë, 10 Nëntor /November 2016

Përgjigjjet në Pyetjet e Dorëzuara në lidhje me Dosjen e Tenderit / Responses to Questions Submitted in Relation t Tender Dossier

Pastrimi i sipërfaqeve të këmbyesve termik

Referenca/Reference: KEKO-16-395-521

Query/Pyetja	Response/Pérgjigija
"O.E. d "O.E. duhet te ofroj dokumentacion i cili do te përfshij kriteret te cilat tregojn mundesit dhe aftësit e tij per realizimin e këtij projekti si: duhet të jenë të certifikuar per punë me enë nën presion perkatsisht certifikata PED97/23EC Lidhur me kërkesen në D. T. se O.E. duhet të ofroj certifikata PED97/23EC, mendojmë se kjo certifikat është e panevojshme sepse kemi të bëjmë me një projekt pastrimi me gryrje, pastrim me ujë dhe zallitje në kohën kur kaldajat nuk janë në punë gjegjësishtuhet jashte prodhimit dhe sistemit gypor I tyre nuk eshte ne presion. Per kete arsyje kerkesa ne DT per certifikat PED97/23EC e konsiderojm diskriminim nga AK per pjesmarrje ne kete projekt .Ju lutemi shqyrtone mundesine largimit te kesaj pike.	Kur kazani nuk është në operim kuptohet që nuk është edhe nën presion, por kjo kërkohet sepse gjatë pastrimit mundet me pasur dëmtime të gypave (e themi këte nga përvoja e deritanishme e pastrimeve) të cilat janë edhe shkaktarë potencial për rrjedhjen e kazanit, për atë arsye dhe për rritjen e sigurisë është kërkuar që O.E. të jenë të çertifikuar edhe me PED97/23EC. Në vijim të përgjigjëjes po ua dërgojë edhe fotot nga disa pastrime të më hershme ku kemi pasur dëmtime, e kjo na shtyri që të kërkojmë nga O.E. me qenë të çertifikuar.

Nga pergjigja e AK, shihet qarte se arsyeja se pse AK ka kerkuar qe punetoret te jene te certifikaur me kete certifikate eshte vetem ne rast se vije deri te demtimi eventual, ky demtim duhet te kryhet nga keta punetore. Kur ne gype demtohet ateher punetoret duhet te jen saldues dhe te te sanojn gypim me saldim sepse gypi nuk sanohet me pastrim. AK insiston ne ate se ne nuk kemi punetore te certifikuar me PED 97/23/EC per pastrim dhe bie ne kudershtim me vetveten kur edhe ka dhen pergjegjen se keta punetore nevojiten vetem ne rast te ndonje demtimi eventual te gypave.

Askund ne bote nuk ka Organ apo kompani qe bene certifikimin e punetoreve per pastrim me kete certifikate PED 97/23/ec. Kjo certifikate leshohet per materialin i cili duhet te perdoret per prodhimin e pajisjeve te ndryshme nen presion si dhe prodhimin e vet pajisjeve nen presion. E vetmja cerifikate e cila leshohet per punetore eshte certifikata e salduesve te cilet duhet te bejen bashkimin /montimin e pjeseve te ndryshme te pajisjeve ne nje pajisje te vetme. Kryesisht vetem fabrikat te cilat e bejen prodhimin e pajisjeve me presion, bejen edhe certifikimin e punetoreve te vet te cilet edhe do te bejen montimin e pjeseve te ndryshme. Ne lidhje me kete Certifikate, se bashku me kerkesen tone per rishqyrtim, ne kemi dergur tek AK edhe nje udhezim te leshur nga Bashkesia Europiane se per cilat

raste dhe per cka eshte e nevojshme qe nje prodhues te certifikohet me kete certifikate. Mirepo prape se prape AK nuk e ka marre parasysh kerkesen tone dhe sqarimin te cilin e kemi dhene dhe insiston se ne nuk posedojm certifikaten PED 97/23/ec per punetore per pastrin por kemi certifikaten PED 97/23/ec per saldues. Nuk e dijm se ide e kujt ka qen qe per pastrim te thjesht nga hiri i grumbulluar ne keta gypa, te kerkohen punetore te certifikaur me certifikate PED, mirepo eshte shume e qarte se kjo kerkese eshte bere me qellime te caktuara vetem qe te kufizoj numrin e OE te cilet jane te interesuar te marrin pjese ne kete tendere dhe meqenese ne veq kemi derguar listen e punetoreve te pajisur me cerifikaten e kerkuar, tani per AK , certifikatat e prezintuar nga ana johe nuk jane te vlefshme sepse nuk jane per pastrim. Me nje hulumtim te thjeshte ne internet ne lidhje me kete certifikate, mund te gjindet lista e te gjitha kompanive te akreditura qe bejen certifikimin me kete lloj certifikate si dhe per cka leshohet kjo certifikat dhe kush duhet te pajiset me keto certifikata.(lista eshte 138 faqe ku perfshihen te gjitha kompanit e akredituara ne Europe duke perfshire edhe vendet ne rajon, si dhe per cfare leshohet kjo certifikate) Linku ku mund te gjendet kjo liste e kompanive te akreditura, si dhe shume udhezime tjera ne lidhje me certifikaten PED eshte: http://ec.europa.eu/growth/tooldatabases/nando/index.cfm?fuseaction-directive.pdf&refe cd-97%2F23%2FEC&reuesttimeout-900 apo thejsht me nje kerkese negoogle- LIST OF BODIES NOTIFIED UNDER DIRECTIVE . 97/23/EC Pressure

Prandaj, kerkojm dhe insistojm nga AK qe te na tregoj se si duken keto certifikata te cilat i kerkon dhe cili eshte organi apo kompania qe i leshon keto certifikata PED per pastrim, sepse ne dyshojn qe nese AK e shperblen nje OE tjeter, eshte e pamundur qe dikush te kete certifikaten PED per pastrim, sepse siq e cekem me larte nuk ka kompani te akredituar qe bene certifikimin e punetoreve me kete certifikate per pastrim.

IV. Arsyetim tjeter i AK per eleminimin tone eshte edhe: citojm:

I - Numri i puntorëve që posedojnë çertifikatën për punë në lartësi është shumë i vogël (4 punëtorë). Krahasuar me vëllimin e punëve dhe periudhën prej 18 ditë për një bllok (që mvaret prej kohëszgjatjes së remonteve) është e pamundur që me këtë numër të punëtoreve të kryhet punë kualitative.

Arsyetimi i yne eshte:

Siq edhe kemi sqaruar ne dosjen tone te tenderit ne faqen 26, numri i puntoreve te cilet do te anagozhohen ne pastrimin e sistemit gypor te kembyesve termik eshte 23 dhe sipas nevojes ky numer mund te shtohet. Edhe ne letren e vet standarde per eleminim si dhe ne vendimin e vet Komisioni i vleresimit insiston se ne kemi numer te Voget te punetroeve te specilaizuar per pune ne lartesi.

1. Ne dosjen e tenderit nuk eshte e cekur se sa duhet te jete numri i punetoreve te cilet duhe te jen te specilaizuar per pune ne lartesi, keshtu qe AK nuk ka te drejt te beje nje vleresim te till. Ne lidhje me numrin e punetoreve, dihet se nje numer i punetoreve eshte i specilaizuar per montimin dhe demontimin e skeleve, e dihet se keta punetore jane te specilaizuar edhe per pune ne lartesi. Edhe AK e din se per kryerjen e nje pune te caktur nuk mundet qe te gjithe punetoret te jene te specializuar por ka edhe punetore ndihmes te cilet duhet ti kryejn punet. Prandaj shihet qarte se arsyetimi i AK eshte jo i logjikshem dhe diskriminues kur vjen ne perfundim se ne do te kryejm punen vetem me 4 punetore dhe nuk i llogarite edhe punetoret tjere ne liste. Per me teper nuk e merr parasysh faktin se ne te njeten pune e kemi kryer edhe ne vitin 2014 dhe 2015, kur ka qen shume me e veshtire te kryhen keto pune

sepse pastrim i bere ne kete periudhe eshte pas nje peridhe te gjate qe nuk eshte bere pastrimi dhe sidomos edhe demtimet te cilat kane qen ne gypa pas shperthimit te elektorlizen ne TCA ne qershor te vitit 2014, dhe punen e kryer me afate dhe ne perputhje te plote me kerkesat e AK.Si perfundim e tere kesaj, ne mund te themi se se eleminimi i yne nuk ka baze ligjore dhe eshte ne kundershtim te plote me LPP ne fuqi, eshte diskriminues dhe tendencioz.Ajo qe eshte shume e rendesishme te ceket ne kete rast eshte se AK, ne nguti qe te na eleminoj nga procedurat e metejm te prokurimit dhe te anuloj aktivitetin e prokurimit per qellime te caktuara, zyrtari i prokurimit ka harruar nje te zabatoj nje dispzite shume te rendesishme te LPP dhe ate VALIDITETIN E TENDRIT. Hapja e tenderit eshte bere me date 17.11.2016 dhe ka qene valid per 90 dite nga dita e hapjes se tenderit, saktesisht deri me daten 16.02.2017. Me date 28.02.2017, AK publikon njoftimin e aktivitetit te prokurimit pa validitet (12 pasi qe skadimit te Valaiditetit te tenderit) dhe ka bere shkelje te nenit 31, paragrfit 31.4 te RUOPP sepse nuk bere kerkese me shkrim per vazhdimin e validitetit te tenderit e qe sipas ketij neni, kete kerkese eshte dasht te beje para dates 16.02.2017 (bile me se largume date 15.02.2017) Prandaj, AK nuk mund te anuloj nje aktivitet te prokurimit pa validitet i cili po ashtu eshte ne kundershtim edhe me vendimin e juaj (vendimin e OSHP-se) nr.884/14 te dates 25.11.2014. Per me teper, ne baze te pervojes tone, mund te konstatohet se edhe zvarritja ne vleresim eshte e paarsyeshme sepse ky aktivitet i prokurimit nuk eshte i ndonje natyre komplekse qe kerkon afate shtese per vleresim dhe po ashtu me ket raste AK ka bere shkelje edhe te nenit 41, paragrafit 41.2 sepse sipas ketij paragrafi AK, proceduren e vleresimit krahasimit dhe egzaminimit te tendereve duhet te perfundoj ne nje periudhe prej 30 diteve nga dita e hapjes se tendereve dhe vetem ne raste te justifikueshme per shkak te natryes komplekse te kontrate kjo periudhe mund te vazhdohet edhe per 20 dite. Mirepo ne rastin konkret, AK nuk e ka perfundu vleresimin ne perputhje me kete nen dhe per me teper nuk ka bere kerkese per vazhdim te validitetit te tenderit. Prandaj, kekrojm nga ju si Organ kompetent qe me autorizimin dhe autoritetin qe ju jep LPP- ne fuqi, te ktheni kete aktivitet te prokurimit ne Rivleresim dhhe te ndermerrni mas ndaj personit/personave te cilet ne menyre direkte apo indirekte jane perfshire ne keto shkelej te qellimshme ligjore.

Demi Material

Shkelejt e nje pas njeshme te LPP-se ne fuqi nga ana e AK. duke na diskriminuar me vleresimin e vet jo profesional qe eshte ne kundershtim te plote me etiken profesionale te prokurimit publik, na demton materialisht por ne te njejten kohe per qellime te veta personale demton edhe vet AK.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	28.10.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Punë /vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	17.11.2016
Data e hapjes së ofertave	17.11.2016
Data e njoftimit të anulimit ne Krpp-së :	27.02.2017

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

- Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), që mund të shkarkohet nga http://krpp.rksgov.net.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04/L-042, Neni 65, siç është e cekur ne piken a deri ne i do të dorëzohen në formë të Aneksit
2. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesitper piken j deri ne q .
3. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata tatimore e vendit të themelimit të Operatorit ekonomik, se Operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë ne pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.
   - Për piken 2 dhe 3 kërkohet vetëm nga Operatori ekonomik qe propozohet për dhënien e kontratës

III.2.2 Përshtatshmëria profesionale

Kërkesa:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Regjistrimi i TVSH;
3. Regjistrimi i numrit fiskal;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e çertifikatës së biznesit);
2. Kopja e TVSH-se;
3. Kopja e numrit fiscal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar **N/A**

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kerkesat:

1.Se paku dy referenca ne vlera jo me pak se 70,000.00 € punëve të natyrës së ngjajshme në tri vitet e fundit

2.Kualifikimet shkollore dhe profesionale te personelit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- Një listë që specifikon performancën : punët e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin .Operatori ekonomik duhet të bashkangjes minimum 2 (dy) referenca për ekzekutimit të mirë te punëve të natyrës së ngjajshme në tri vitet e fundit (2013,2014 dhe 2015), në vlera jo me pak se 70,000.00 € .
- Lista e personelit teknik qe do te angazhohet ne realizimin e projektit
  - Operatori ekonomik duhet te përcaktoj Menaxherin e Projektit, me përgatitje profesionale inxhinier i diplomuar i makinerisë, këtë duhet ta dëshmoj me CV dhe kopje te diplomës,

Të deshmohet me CV përvoja e personelit që angazhohet në kryerjen e punëve.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"NPSH Electronik Business Pro'	Prishtinë	57,423.78 €	JO

2.	"Monting Energjetika" sh.p.k	Prishtinë	74,284.92 €	JO
3.	"Ar-Tech" sh.p.k	Prishtinë	68,327.31 €	JO
4	"Intering" sh.p.k	Prishtinë	69,014.68	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 17.11.2016, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë katërmbëdhjetë (4) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Kryetar i komisionit – Arsim Thaqi
- Anëtar i komisionit - Nexhat Osmani
- Anëtar i komisionit – Vllaznim Emërllahu

Data e mbarimit të vlerësimit: 15.02.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga eksperti kryesor i prokurimit:.....16.02.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vleresuas pas kontrollit dhe verifikimit te ofertave konkurruese ka ardhur ne perfundim se ne mungese te se paku nje oferte pergjegjeshme ky tender te anulohet dhe nese eshte e nevojshme i njejti te ritenderohet.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues - teknik (N. 306)

Eksperti shqyrtues - teknik, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palëve në ankesa sqarojn me sa vijon:

Sqarimi nr .1. Autoriteti Kontraktues - **"Korporata Energjetike e Kosovës"**, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë, kontrat publike me vlerë të mesme, operatorët ekonomik: **"Ar Tech",shpk,** dhe **"Electronik Business – PRO",** kanë parashtruar ankesa veq e veq kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, respektivisht kundër arsyetimeve të eleminimit te shprehura në letra standarde kundrejt të njejtëve OE.

Arsyetimi i letres standarde kundrejt ofertës së parashtruesit të ankesës, **""Ar Tech",shpk,** porencon: *"... Numri i punëtorëve që posedojnë çertefikaten për punë në lartësi është shum i vogël (5 punetorë). Krahasuar me vëllimin e punëve dhe periudhen prej 18 dite për një bllok (që mvaret prej kohëzgjatjes së remonteve) është e pamundur që me këtë numër të punetoreve të kryhet pune kualitative".*

Arsyetimi i letres standarde kundrejt ofertës së parashtruesit të ankesës, **"Electronik Business – PRO"**, porencon: *"... Nuk e plotesoni kriterin e kërkuar në njoftim për kontratë, neni III.2.4) "kapaciteti teknik dhe profesional", apo neni 9.1, te FDT-se, të dosjes së tenderit ku është kërkuar "kërkesat mbi mundesitë teknike dhe ose profesionale", ku është kërkuar: Një listë që specifikon*

përformancën: punët e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesisn. OE duhet të bashkangjes ***minimum 2(dy) referenca*** *për ekzekutimit të mirë të punëve të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit (2013, 2014 dhe 2015), në vlera jo më pakë se 70,000,00€.*

Ju në ofertë keni prezantuar vetëm një ofertë e cila i ka plotesuar kriteret e kërkuara dhe ka qenë e natyres së ngjashme.

- *Eshtë kërkuar certefikata PED 97/23 EC për kryerjen e punëve me enë nën presion , ndërsa keni ofruar certefikaten e sallduesve PED 97/23 EC për paisje nën presion, në këtë projekt nuk ka salldim por pastrim të siperfaqeve të këmbyesve termik.*
- *Numri i punëtorëve që posedojnë certefikaten për punë në lartësi është shum i vogël (4 punetore). Krahasuar me vëllimin e punëve dhe periudhen prej 18 dite për një bllok (që mvaret prej kohëzgjatjes së remonteve) është e pamundur që me këtë numer të punetoreve të kryhet punë kualitative".*

OE "Ar – tech", më datën 21.02.2017, ka parashtruar kërkesë pranë AK-së, me pretendimet ankimore se AK, ka bërë shkelje të nenit 1.6,7,28,59 dhe 69, të LPP-së, ndërsa OE **"Electronik Business – PRO"**, sipas përshkrimit më datën. 21.02.2017, ka parashtruar kërkesë pranë AK-së, me pretendimet ankimore se AK, ka bërë shkelje të nenit 1,7,10, dhe 59, të LPP-së. AK – KEK, më datën 23.02.2017, nxjer vendime veq e veq dhe refuzon kërkesat si të pa bazuara me arsyetimin si në letra standarde.

Sqarimi hyrës: Pretendimet ankimore janë trajtuar – shqyrtuar nga eksperti teknik, pasi që i njejti të gjitha shkresat e lendës për këtë aktivitet të prokurimit, i ka partur në posedim, dhe atë si më poshtë:

Sqarimi nr 2. - Ankesa nr. 59/1 - OE "Ar- Tech" shpk.

Ekspereti teknik sjaron se pretendimet kryesore ankimore të parashtruesit të ankeses OE "Ar - tech"shpk, kanë të bëjnë me arsyetimin e eleminimit të potencuar si në sqarimin nr.1, të këtijë raporti. Të njejtin arsyetim e kualifikojmë si të pa bazuar pasi që parashtruesi i ankesës sipas shkresave të lëndës ka deklaruar që për punët e parapara në këtë aktiviet të prokurimit dhe atë duke potencuar afatin prej 18 ditë kalendarik. Po ashtu i njejti ka prezantuar listen e punëtorëve, ku janë të përshkruar mbi 20 punëtorë, në mesin e tyre rezulton të jene 5 (pesë) punëtor të çrtifikuar për punë në lartësi. Gjithashtu OE ankues ka prezantuar metodologjin e punimeve për punimin e pastrimit të siperfaqeve ngrohëse në kaldaja të avullit A3, A4 dhe A5, Për më teper AK - KEK, në dosjen e tenderit , konkretisht tek kërkesat mbi mundësinë teknike dhe profesionale nuk e ka specifikuar numrin e puntorve të çërtifikuar për punë në lartësi, por ka kërkuar listen e personelit teknik që do të angazhohen në realizimin e projektit, andaj pretendimet ankimroe të të njejtit OE i kualifikojmë si të bazuara.

Sqarimi nr 3. - Ankesa nr. 65/17 - OE "Electronik Business – PRO"

Pretendimet kryesore ankimore të të njejtit OE poashtu kanë të bëjnë me arsyetimin e eleminimit të potencuar në sqarimin nr.1, teë këtijë raporti. Të njejtin arsyetim e kualifikojmë si pjesërisht të bazuar, konkretisht arsyetimin sa i përket kërkesës që lidhet me kapacitetin teknik dhe profesional, e kualifikojmë si të bazuar pasi që parashtruesi i ankeses ka ofruar vetëm një referenc të natyrës së njëjt, ndërsa referenca tjetër me titull "sanimi i siperfaqeve të konstruksionit prej betoni të armiruar të kulles ftohëse në bllokun A4", vleresimi ynë është që e njejta nuk është e natyrës së njejte për këtë aktiviteti të prokurimit.

Poashtu edhe arsyetimin tjeter lidhur me kërkesen për çertifikatën "PED 97/23 EC" për kryrjen e

punëve enë nën presion", e kualifikojme si të bazuar pasi parashtruesi i ankeses në shkresa të lëndës posedon çertefikaten PED 97/23 EC, sipas përshkrimit në të për saldim.

Ndërsa arsyetimin tjetër lidhur me numrin e punëtorëve, e kualifikojmë si të pa bazuar pasi që OE ankues në ofert ka deklaruar që për punët e parapara për kete aktivitet të prokurimit, qe punët do të perfundojn në afatin prej 18 ditë kalendarik. Po ashtu OE ankues prezantuar listen e puntorve prej mbi 20 punëtor të cilet 4 (katër) prej tyre janë të çrtifikuar për punë në lartësi. Po ashtu i njejti OE ka prezantuar metodologjin e punimeve për punimin e pastrimit të siperfaqeve ngrohëse në kaldaja e avullit A3, A4 dhe A5. AK- KEK në dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësinë teknike dhe profesionale nuk e ka specifikuar numrin e puntorve të çërtifikuar për punë në lartësi, AK-ja ka kërkuar listen e personelit teknik që do të angazhohen në realizimin e projektit, e që OE ankes e ka ofruar.

Poashtu parashtruesi i ankeses "Electronik Business – PRO", përmes deklaratës në ankesë pretendon edhe për mos respektim të nenit 10, të LPP-së, dike bashkangjitur prova shkresore ankesës, kopjen e kërkesës për qasje, ndërsa AK- KEK, poashtu përmes shkreses elektronike përgjigjet, duke i mundesuar qasje vetëm në ofertën e tijë jo edhe në ofertat tjera, rrjedhimisht veprimi si i tillë paraqet mos respektim të nenit 10, të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues - teknik:

Eksperti shqyrtues - teknik, bazuar në sqarimet e cekura në raport, mendon që Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës, për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Pastrimi i sipërfaqeve të këmbyesve termik"** me nr. të Prokurimit: **KEKC 16/395/521,** nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.

Prandaj propozimi ynë për panelin shqyrtues është që ky AP, të kthehet në **RI-VLERESIM**, ndërsa ankesa e OE **"Ar-tech"shpk, të aprovohet si e bazuar,** ndërsa ankesa e **"Electronik Business – PRO",** të aprovohet si **pjesërisht e bazuar.**